

THIRRJE PËR AVOKAT

PËR OFRIMIN E NDIHMËS LIGJORE FALAS

Tiranë, më 7.10.2022.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në kuadrin e projektit “Forcimi i grave të dhunuara dhe vulnerable me edukim ligjor, ndihmë ligjore falas dhe advokaci”, i cili zbatohet nga QNL në kuadër të programit “Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të grave në Shqipëri” zbatuar nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) me mbështetjen financiare të Agjencisë Suedeze për Zhvillim e Bashkëpunim (SIDA), kërkon të kontraktojë një avokat për të ofruar shërbimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore falas.

Preferohen avokatë me përvojë në mbështetjen e individëve nga grupet e marginalizuara.

Përshkrimi i detyrave

Avokati/ja do të angazhohet për kryerjen e detyrave si më poshtë:

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kontribuon përmes ofrimit të shërbimeve ligjore falas për gra dhe vajza të dhunuara në marrëdhëniet familjare, të trafikuar ose në rrezik trafikimi, të diskriminuara për shkaqe gjinore dhe të shumëfishta dhe çështje të tjera me të cilat përballen grupet e marginalizuara. Shërbimi ligjor falas përfshin ndihmë ligjore parësore dhe dytësore, duke përfshirë informimin e përfituesëve, këshillimin ligjor, përgatitjen e akteve për në gjykatë dhe institucione të tjera, përfaqësimin e rasteve në gjykatë dhe institucione të tjera, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- Të kontribuojë në identifikimin dhe mbështetjen e rasteve strategjike;
- Të referojë rastet për mbështetje, në varësi të nevojave të veçanta të rastit, pranë Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe organizatave që ofrojnë shërbime të tjera falas;
- Eshtë përgjegjëse për regjistrimin e rastit në databazën e klientit dhe updatimin e regjistrimit sipas progresit të rastit dhe dërgimin e raporteve mujore pranë DNJF;
- Eshtë përgjegjëse për dokumentimin e këshillimeve ligjore të ofruara duke përmbushur standardet e dokumentimit si përshkrimin e shërbimit të ofruar, datën e ofrimit të shërbimit, referimin e rastit, firmosjen e këshillimit nga klientja/i dhe avokatja;
- Eshtë përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të dosjes së klientes, që përfshin dokumente të paraqitura nga klientja/i dhe akte të përgatitura nga avokatja në mbështetje të klientes;
- Ruan dokumentacionin dhe të dhënat personale sipas legjislacionit në fuqi, duke respektuar konfidencialitetin e tyre;
- Këshillon, mbikqyr dhe organizon punën e skuadrave pro bono, të krijuara në kuadrin e projekteve të ndryshme të zbatuara nga qendra;
- Kontribuon në forma të ndryshme për rritjen e njohurive të komunitetit mbi të drejtat ligjore, në mënyrë të veçantë grave dhe vajzave dhe merr pjesë në aktivitete informuese në Tiranë, dhe zona rurale;

- Të përgatisë histori suksesi nga shërbimi ligjor falas i ofruar;
- Ofrom shërbimet ligjore falas duke respektuar etikën e kërkuar dhe në përmbushje të të drejtave të klientit/es.

Periudha kohore:

Detyrat dhe përgjegjësitë do të përmbushen për një periudhë të shkurtër nga lidhja e kontratës deri më 31 Dhjetor 2022.

Kualifikimet e kërkuara të kandidatëve:

- Të këtë mbaruar studimet Bachelor në drejtësi;
- Të këtë të paktën 1 vit përvojë në informim, ndërgjegjësim e këshillim të qytetarëve si dhe në ofrimin e ndihmës ligjore për çështje pronësore të grave, familjare dhe mbrojtje nga dhuna në marrëdhëniet familjare ose forma të tjera të dhunës me bazë gjinore, diskriminimi, etj;
- Të këtë licencë avokati;
- Të njohë shumë mirë paketën microsoft office;
- Të jetë i/e motivuar në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të caktuara.

Përvoja e mëparshme pranë organizatave të shoqërisë civile, është shumë e vlerësueshme.

Pagesa

Fee për shërbimin e ofruar është 420 (Katërqind e njëzetë) Eur bruto në muaj.

Dokumentet:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

1. CV e kandidatit/es;
2. Kopje e Diplomës, e studimeve Bachelor;
3. Licensën e avokatit;
4. Çdo dokumentacion i nevojshëm që tregon kualifikimet e kandidatit/es dhe përvojat e mëparshme;
5. Dëshmi e penalitetit;

Dokumentacioni mund të dërgohet i skanuar në adresën e emailit avokatore2@yahoo.com ose, të depozitohet pranë zyrave të Qendrës për Nisma Ligjore me adresë Rruga “Vaso Pasha” Pll.12, Shk.1, Ap. 1 Tiranë.

Afati i aplikimeve:

Afati i fundit i aplikimeve do të jetë data 17.10.2022.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare rezervon të drejtën që ta shtyjë afatin e thirrjes ose ta anullojë atë, nëse aplikantët/et nuk përmbushin cilësinë dhe kriteret e kërkuara.